

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 1 nga 3

Kodi: 043

AVOKIMI DHE ANGAZHIMI NË KOMUNITET

Tipi i programit: Plotësues

Hyrje:

Në një shoqëri demokratike, pjesëmarrja aktive e qytetarëve është parakusht që demokracia të funksionojë. Pjesëmarrja qytetare nuk tkurret vetëm në të drejtën e votës, por duhet të sigurohet në të gjitha çështjet për të cilat kërkohet vendimmarrje e cila ndikon në jetën e qytetarëve. Në këtë vështrim, sistemi i arsimit luan një rol të madh, pasi i përgatit njerëzit që të marrin pjesë në mënyrë demokratike në mënyrën se si do të rregullohen çështjet e ndryshme në shoqëri.

Qendra për Arsim e Kosovës, një kohë të gjatë ka zbatuar projekte në fushën e edukimit për të drejtat e njeriut, demokracisë dhe pjesëmarrjes qytetare. Më konkretisht, përmes projekteve të financuara fillimisht nga Bashkimi Evropian (EU) dhe pastaj edhe nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur (OSI), janë zhvilluar programe trajnimi dhe mundësi aktivizimi në fushën e avokimit dhe angazhimit në komunitet.

Programi i trajnimit “Avokimi dhe angazhimi në komunitet”, është një program trajnimi i zhvilluar mbi bazën e përvojës me zbatimin e projekteve në këtë fushë, duke e kthyer këtë përvojë në një program të strukturuar që i ndihmon profesionistët arsimorë që të zhvillojnë kapacitetet e nxënësve dhe të rinjve për angazhim në komunitet dhe dialog me qeverisjen lokale dhe vendore.

Qëllimi i programit dhe rezultatet e pritura:

Qëllimi i programit të trajnimit është që të ofrojë një metodologji të strukturuar të planifikimit dhe zbatimit të nismave avokuese dhe atyre komunitare, si pjesë e fuqizimit të nxënësve si qytetarë të rinj të vendit, që të angazhohen në çështjet me rëndësi për ta dhe komunitetet e tyre.

Pas përfundimit të programit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë që kanë avokimi dhe angazhimi në komunitet për demokracinë;
- Të dallojnë nismat avokuese nga nismat ndërgjegjëse në komunitet;
- Të vlerësojnë në mënyrë kritike rregullimin e jetës publike në nivel lokal;
- Të identifikojnë çështje të rëndësishme për komunitetin, që duhet të adresohen;

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 2 nga 3

- Të analizojnë çështjet/problemet, përmes dëshmive/fakteve lidhur me to, si dhe ndikimit që ato kanë në jetën e qytetarëve;
- Të analizojnë palët e interesuara/përfshira në çështjet dhe pozicionet e tyre;
- Të ndërtojnë kauzën për adresim të çështjes, përmes përcaktimit të qëllimit të qartë/ndryshimit të gjendjes në një të ardhme;
- Të hartojnë një plan të qartë veprimi, ku përfshihen mesazhet/kërkesat që u bëhen vendimmarrësve lidhur me çështjen;
- Të identifikojnë burimet e veçanta që mund të nevojiten, në mënyrë që nisma avokuese të jetë e suksesshme.

Përmbajtja

Ky program trajnimi mbështetet në pjesëmarrjen aktive të pjesëmarrësve përmes planifikimit të nismave avokuese dhe/apo nismave ndërgjegjësuese në komunitet. Ndërsa, pjesëmarrësit do të njihen me konceptet kryesore që lidhen me angazhimin qytetar dhe metodologjinë për një angazhim të këtillë, ata do të kenë mundësinë që përgjatë programit të trajnimit të identifikojnë çështje të vërteta e të rëndësishme – dhe përmes metodologjisë së ofruar – të planifikojnë nisma avokuese ose ndërgjegjësuese. Metodologjia e punës është në masë e bazuar në ciklin e menaxhimit të projektit, ndërsa temat që trajtohen përfshijnë:

- Avokimi – aspekte konceptuale;
- Të nxënit përmes angazhimit në komunitet (service learning);
- Rregullimi i jetës publike në nivel lokal – vlerësim kritik;
- Identifikimi i çështjeve me rëndësi për t'u adresuar;
- Analizimi i çështjeve/problemeve të përzgjedhura për adresim;
- Vendosja e qëllimit të nismës avokuese;
- Strategjia e veprimit për nismën avokuese;
- Burimet e nevojshme;
- Analiza e suksesit/korniza e vlerësimit të nismave.

Grupi i synuar

Programi në radhë të parë u dedikohet mësimeve, në mënyrë që ata të fuqizohen vetë si qytetarë aktivë – e për më shumë – t'i edukojnë nxënësit për nevojën e angazhimit qytetar dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre në këtë drejtim. Megjithatë, programi është i përshtatshëm për të gjithë profesionistët arsimorë, por edhe të fushave tjera. Përfitues mund të jenë edhe prindërit, ndërsa veçanërisht programi mund të ofrohet për nxënësit e të rinjtë e angazhuar, sikurse janë anëtarët e këshillave të nxënësve, të organizatave tjera të fëmijëve, të organizatave rinore, etj.

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v. 2.0	Faqe 3 nga 3

Forma e organizimit/kohëzgjatja

Programi i ka 24 orë. Ai realizohet në formë të programit treditor të trajnimit (18 orë), i shoqëruar me mbështetje gjatë punës në planifikimin e nismave avokuese (6 orë). Forma e organizimit dhe kohëzgjatja është si vijon:

- Ofrimi i programit të trajnimit (që mund të ofrohet për tri ditë rresht ose në formatin 2 + 1 ditë);
- Konsolidimi i nismave avokuese, nën mentorimin e trajnerëve;

Pjesëmarrësit inkurajohen që nismat avokuese ose ato të angazhimit në komunitet t'i zbatojnë, ndërsa trajnerët e programit qëndrojnë në dispozicion për mentorim të mëtejshëm.

Vlerësimi/Certifikimi

Pjesëmarrësit certifikohen gjithsej për 24 orë (18 orë trajnimi si dhe 6 orë zhvillimi përmes punës).

Kriteret për certifikim janë:

- Pjesëmarrja aktive në trajnim, së paku në 90% të kohëzgjatjes së trajnimit; dhe
- Dokumentimi i planifikimit të nismës avokuese (të identifikuar që në kohën e trajnimit)

Materialet e trajnimit

Dokumenti kryesor për trajnimin është udhëzuesi për trajnerë, i cili u shërben trajnerëve në ofrimin e suksesshëm të programit të trajnimit. Në pjesë të caktuara të programit të trajnimit përdoret prezantimi në Power Point për aspektet konceptuale, ndërsa rregullisht përdoren fletat e punës për praktikim të metodave të punës. Pas trajnimit, pjesëmarrësit e pranojnë shabllonin e planifikimit të nismës avokuese.